

Kompania **Safecomm Sh.p.k.**; **“Perskrimi i rrjetit dhe i sherbimeve telefonike”**.

## **HYRJE**

**Safecomm Sh.p.k.**, nje kompani e cila me hyrjen ne treg synon qe me nje investim serioz te ofroje nje game sherbimesh si telefoni, internet dhe VPN me nje cilesi dhe cmim nga me te miret te treg. Fillimisht kompani jone synon te ofroje sherbimin telefonik me nje cilesi HD dhe me cmimet me te mira ne treg ne perputhje me rekomandimet e AKEP.

Kompania synon te filloje ofrimin e sherbimit telefonik ne 20-01-2023 kryesisht ne disa zona te qytetit te Tiranes, ku aktualisht kompania eshte ne fazet e studimit te fizibiliteti te rrjetit dhe marrjen e lejeve perkatese pas Autorizimit te Pergjithshem.

Kompania synon te ndertoje nje rrjet backbone i mbeshtetur ne fibra optike pergjate akeseve kryesore te qytetit dhe me pas me instalimin e rrjetit twisted pair te nje cilesie te larte per te ofruar sherbime triple play ne te ardhmen duke plotesuar gamen e sherbimeve me internet dhe rrjeta VPN. Ne kete dokument eshte prezantuar perskrimi i detajuar i rrjetit qe do te ndertohet ne qytetin e Tiranes dhe ne disa qytete te tjera si : Tropoje, Kruje, Kukes, Kavaje ,Durrës, Fier, Lushnje, Vlore, Korce, Gjirokaster dhe sherbimeve qe Safecomm do te implementoje ne te ardhmen. Safecomm do te vazhdoje edhe ne te ardhmen te zgjeroje me elemente te rinj rrjetin dhe sherbimet e ofruara duke mbajtuar standartet me te larta qe kerkohen nga AKEP dhe organizmat nderkombetare, duke marre pozicionin e nje sipermarresi pionier ne politikat e liberalizimit per sektorin e komunikimeve elektronike. Ky dokument paraqet arkitekturen e rrjetit qe do te ndertohet , pajisjet qe perdoren, sherbimet qe do te ofrohen ne menyre te detajuar dhe dhe parametrat e kualitetit te sherbimit te ofruara

## **1.1 Arkitektura dhe rrjeti qe do te ndertohet .**

Arkitektura dhe rrjeti i Safecomm sh.p.k, eshte projektuar qe te ofrojne besueshmeri dhe kualitet sherbimi te larte. ne vetvete dhe ne arkitekturen qe do te implementoje ka pasur si qellim final nivelin e larte te suportit me disa nivele (Incident& Problem Management – ITIL v.3) si dhe krijimin e arkitekturave redundante me pajisje me nivele te larta te MTTF (Mean Time to Failure) per te krijuar nje model te ri ne tregun shqiptar.

Rrjeti i Safecomm qe do te implementohet ka si qellim primar ofrimin e sherbimeve telefonike dhe ti integroje ato ne te ardhmen me sherbimet VoIP dhe ofrimin e sherbimeve alternative bazuar ne protokollin IP duke shfrytezuar liberalizimin e tregjeve te telekomunikacionit.


Rrjeti i Safecomm do te konsistoj ne disa nivele hierarkike te cilat identifikohen si Pika Prezence (PoP “*Point of Presence*”) dhe NOC (*Network Operation Center*).

Rrjeti i Safecomm eshte projektuar per te pasur redundance dhe gjithashtu duke u bazuar fort ne investime eficiente, me qellim qe infrastruktura e implementuar te kete mundesine te perdoret gjeresisht dhe maksimalisht nga sherbimet alternative te telekomunikacionit qe perbejne dhe objektin e shoqerise Safecomm sh.p.k.

Safecomm aktualisht eshte ne fazen e projektimit dhe te implementimit te rrjetit Core, i cili do te jete plotesisht funksional ne muajin 15-02-2023 ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me standartet dhe direktivat nderkombetare per ofrimin e sherbimeve te komunikimeve elektronike.

Safecomm me investimet e tij do te ndertoje nje rrjet me fibra optike dhe pika prezence ne disa segmente te qytetit te Tiranes . Keto investime te Safecomm do te plotesojne maksimalisht kerkesat dhe do te ofrojne kapacitete per pale te treta, te cilat mund te kerkojne akses ne te ardhmen, ne sherbim te komunikimeve elektronike dhe politikave te telekomunikacionit ne Republiken e Shqiperise.

Skema e rrjetit qe do te ndertohet dhe arkitektura e sistemit core eshte si ne figure:



*Figura 1 : Arkitektura dhe Rrjeti i Safecomm*

## 1.2 Shpjegime te sistemit dhe rrjetit

Ne mjediset e Albtelecomit ne baze te marreveshjes do te kryhet interkoneksioni mes “Data Center Albtelecom, Rruga Ibrahim Rrugova”, Tirane, kryehet ne nivel SIP . Ne zyrat e kompanise do te instalohem te gjitha paisjet, lidhja e te cileve me Albtelecom behet me IP. Serverat e tarifimit 2 cope te prodhimit Dell, te cilet realizojne ne kohe reale lidhjen dhe autentifikimin e e klases se perdoruesve prepaid; serveri i database-it i cili ruan te gjitha CDR (call detail record) per cdo abonent te lejuar dhe per klasat prepaid numrat e autefikimit qe do te perdoren; nje server backup ne rast te mosfunksionimit te ndonjerit nga serverave te mesiperm; Web Server i cili lejon mundesine e kotrollit te thirrjeve te zhvilluar ne cdo kohe nga sherbimi web, si dhe nje nje switch Catalyst 2950 qe ben te mundur lidhjen e te gjithave paisjeve te mesiperme ne rrjet.

Lidhja e abonenteve do te behet duke shfrytezuar lidhjet ne PoP me fiber optike per te ofruar ne te ardhmen sherbime te integruar dhe sherbime triple-play, duke perdorur nje multiplekeser ATA i cili pershtatjen TW ne IP mbi fiber optike, i prodhimin Cisco. Sherbimi do te ofrohet ne mjediset e Data Center Albtelecom Tirane.

Protokollet qe do te perdoren te implementimin e sherbimit telefonik do te jene:

- Protokoli qe do te perdoret per interkoneksion SIP

- kodimi i kanalit g.711 , g.729 . RFC2833
- protokolli i lidhjes se paisjeve, IP GigaEthernet
- Paisjet e rrjetit Cisco router 2600 series, Catalyst 2590
- Paisjet dhe serverat e tarifimit HP dhe Dell server
- Programet e tarifimit dhe baza e te dhenave Oracle.

### **1.3 Portabiliteti i numrit**

Portabiliteti i numrit qe do te ofroje kompani jone Safecomm do te bazohet ne programin Mind-SS te zhvilluar nga MindCTI. Ky aplikim eshte ndertuar sipas metodes ACQ ose pre-routing lookup bazuar ne nje database SQL per te gjetur prefiksin e rutimit drejt operatorit te duhur. Prefikset e rutimit te perdoruara jane te ruajtuara vecmas databases ku mbahen te gjithë numrat e portuar. Nqs nje thirrje vjen ne Mind-SS kjo thirrje analizohet me database e numrave te portuar dhe nqs se gjendet aty i vendoset prefiksi i rutimit te operatorit ku ky numer eshte portuar dhe kjo thirrje drejtohet ne kapacitetet e interkoneksionit perkates. Perditesimi i kesaj database lokale do te behet cdo gjashte ore duke marre nga CRDB te gjithë numrat e portuar te cilet jane shafaqur ne FTP zyrtare, ne te njejten kohe Safecomm dergon drejt CRDB mesazhin npdone qe Safecomm ka perditesuar databasen me te dhenat me te fundit. Nga databasa fshihen te gjithë numrat te cilet jane kthyer tek operatori fillestar si dhe perditesohen numrat te cilet kane kaluar drejt nje opratori te ri pas portimit te tyre te pare. I gjithë ky proces do te jete automatik dhe rrugezimi i thirrjeve te tranzituara nga Safecomm ose te origjinuara nga Safecomm behet sipas te dhenave CRDB-se.

### **1.4 Siguria dhe konfidencialitetit i komunikimit**

Nepermjet menyres se implementimit te rrjetit dhe te sistemeve Safecomm do te garantoje mbrojtjen e të dhënave vetjake dhe të privatësisë. Safecomm, ne kuadrin e marreveshjeve me palet e treta, ofron informacion ne lidhje me strukturen e vet, organizimin dhe veprimtarine. Per rrjedhoje, Safecomm merr persiper te ruaje karakterin konfidencial te informacionit te marre nga operatoret, pajtimtaret, kontraktoret si gje nga cdo subjekt apo entitet qe bashkevepron me Safecomm per sa kohe ky informacion nuk perben nje detyrim

ligjor per paraqitjen e tij prane organeve perkatese. Informacioni i mesiperm, ne çdo forme dhe nese i jepet Safecomm, ka absolutisht karakter konfidencial. Informacioni konfidencial jepet si “i tille”. Safecomm gjithmone do te perdore Informacionin e lartpermendur vetem per qellimet e specifikuara ne kontratat me palet dhe ne perputhje me kuadrin ligjor te RSH, dhe po ne kete kuader do t’ua beje te ditur punonjesve te tij, bashkepunetoreve, nenkontraktoreve, te cilet me iniciativen e Safecomm do te kene akses per permbushjen e qellimit te mesiperm. Safecomm ndermerr çdo mase te nevojshme, ne menyre qe fshehtesia e vendosur per Informacionin detyron ta zbatojne nenkontraktoret e vet.

Safecom nuk u siguron Informacion Konfidencial, qe mund te sillte avantazh ne konkurrence, kompanive bija apo partnereve te tij.

**1.** SAFECOMM ka percaktuar strategjine dhe perditeson masa ndaj sistemeve të komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave, për të mbrojtur sekretin e komunikimeve elektronike dhe të të dhënave vetjake, si dhe për të ndaluar aksesin e paautorizuar në sistemet e komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave.

**2.** SAFECOMM, të autorizuarit dhe punonjësit e saj jane te detyruar të ruajnë e të mbrojnë të dhënat dhe fshehtësinë e komunikimeve, që kryhen nëpërmjet rrjetit e shërbimeve të tij gjatë gjithë periudhës së kryerjes së veprimtarisë, por dhe pas përfundimit të saj.

**3.** SAFECOMM merr dijeni për mesazhe ose të dhëna të transmetuara nëpërmjet rrjetit të saj, vetëm në masën që i nevojitet për të kryer detyrën në sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

**4.** SAFECOMM ndalon marrjen, regjistrimin, publikimin dhe përdorimin e të dhënave dhe te mesazheve të transmetuara nga rrjeti i saj dhe që nuk janë për publikun, si dhe dhënien e tyre personave të paautorizuar.

Konfidencialiteti i komunikimit qe SAFECOMM respekton përfshin:

- a) përmbajtjen e komunikimit;
- b) të dhënat e trafikut dhe të vendndodhjes në lidhje me komunikimet;
- c) të dhëna për përpjekjet e pasuksesshme për vendosjen e lidhjes.

SAFECOMM do te ndaloj të gjitha format e mbikëqyrjes, përgjimit, ndërprerjes, regjistrimit, ruajtjes, transferimit dhe devijimit të komunikimeve, si dhe të dhënat, referuar pikës 1, përveç rasteve kur kjo është e nevojshme për përcjelljen e mesazheve, të faksit, të postës elektronike, të sekretarisë telefonike, mesazheve zanore, mesazheve të shkurtra apo për rastet e parashikuara me ligj.

**Filip Decka**

**Administrator**

**Safecomm shpk**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Filip Decka', is written over the printed name 'Safecomm shpk'.